



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 1/118


Datë: 02.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 115 e Qeverisë.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/118
Datë: 02.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Themelohet Ministria e Integritit Evropian.
2. Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritit Evropian e themeluar me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/2009 shkrihet në Ministrinë e Integritit Evropian.
3. Ministria e Integritit Evropian është përgjegjëse për bashkërendimin e procesit të integritit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.
4. Fushëveprimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Integritit Evropian përcaktohen me akt të veçantë juridik.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 3/118

Datë: 02.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet raporti përfundimtar i buxhetit për vitin 2009.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 4/118

Datë: 02.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2010, mori

V E N D I M

**PËR PËRBËRJEN, KOMPETENCAT DHE FUNSKIONIMIN E KOMISIONIT
PROFESIONAL PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE PËR BLERJEN E OBJEKTEVE
TË AMBASADAVE**

Përbërja

1. Mbështetur në vendimin e Qeverisë Nr. 02/79, të datës 27 gusht 2009 për emërimin e Komisionit Profesional për zhvillimin e negociatave për blerjen e objekteve të Ambasadave, përbërja e Komisionit të lartcekur është si në vijim:
 - 1.1. Përfaqësues - Zyra e Kryeministrit;
 - 1.2. Përfaqësues - Ministria e Punëve të Jashtme;
 - 1.3. Përfaqësues - Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
 - 1.4. Përfaqësues - Ministria e Administratës Publike.

2. Ambasadori ose shefi i misionit diplomatik të Republikës së Kosovës në shtetin ku negociohet blerja e objektit për Ambasadë është pjesë përbërëse e Komisionit dhe vepron si anëtar i pestë i Komisionit. Ambasadori ose shefi i misionit diplomatik ka të njëjtat të drejta sikurse anëtarët e tjerë të Komisionit.

Kompetencat

1. Komisioni profesional për blerjen e objekteve për Ambasada është kompetent për identifikimin e objekteve të përshtatshme për Ambasada, zhvillimin e negociatave dhe përzgjedhjen finale të objektit të Ambasadës.
2. Komisioni vendos në pajtim me mjetet në dispozicion, të ndara nga Qeveria për blerjen e objektit të Ambasadës, duke u mbështetur në parimet e transparencës, jo diskriminimit dhe ekonomikitetit.
3. Komisioni mund të angazhojë përfaqësues ligjorë në shtetin përkatës të cilët përgatisin të gjitha instrumentet e nevojshme ligjore prej fillimit të negociatave deri në përfundimin e procesit të shitblerjes. Komisioni po ashtu mund të angazhojë një kompani që bën hulumtimin e tregut.
4. Përfaqësuesit ligjor dhe kompania për hulumtimin e tregut, secila veç e veç, kontraktohen pas dërgimit të tri ofertave nga Ambasadori ose shefi i misionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe njëra nga ofertat miratohet nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë, pas rekomandimit të komisionit treanëtarësh që themelohet me vendim të Sekretarit të Përhershëm.

Funksionimi

1. Komisioni udhëhiqet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Komision.
2. Para fillimit të negociatave, Drejtori i Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme i dërgon Komisionit listën e kërkesave të arsyeshme ose të materialeve të nevojshme që Komisioni duhet t'i ofrojë Drejtorit të Prokurimit në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/17 për Prokurim Publik, këtë dhe vendimet e tjera përkatëse të Qeverisë, të cilat janë të nevojshme gjatë identifikimit të objekteve, zhvillimit të negociatave dhe përzgjedhjes së ofertuesit.
3. Kryesuesi i Komisionit në bazë të rregullt, gjatë gjithë procesit të zhvillimit të negociatave deri në përzgjedhjen e ofertuesit, i dërgon të gjitha informatat përkatëse Drejtorit të Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, që përfshinë materialin lidhur me identifikimin e objektit, ofertat dhe dokumentin përcjellës të ofertave, procesverbalin e zhvillimit të negociatave dhe procesverbalin lidhur me vendimin e Komisionit për përzgjedhjen e objektit. Kryesuesi i Komisionit po ashtu përgatit një raport rreth vizitës në shtetin ku zhvillohen negociatat, përfshirë datën, vendin dhe kohën e takimit.
4. Shqyrtimi i ofertave dhe i propozim-kontratave në aspektin ligjor dhe procedural bëhet nga anëtarët e Komisionit, të cilët mbështeten nga përfaqësuesit ligjor të kontraktuar në shtetin ku negociohet blerja e objektit.
5. Pas shqyrtimit të të gjitha ofertave të përshtatshme, anëtarët e Komisionit vendosin për përzgjedhjen e një oferte me konsensus.

6. Në mungesë të konsensusit, vendimi për përzgjedhjen finale të objektit të Ambasadës merret me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit, duke përfshirë Ambasadorin ose shefin e misionit në atë shtet.
7. Komisioni nuk mund të vendosë në mungesë të më shumë se një (1) anëtari të Komisionit.
8. Në marrjen e vendimit, ose në proces të votimit, secili anëtar i Komisionit vendos duke u mbështetur në parimet e transparencës, jo diskriminimit dhe ekonomikitetit.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

 Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 5/118
Datë: 02.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 35,000.00 (tridhjetepesë mijë euro) për Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në programin me kod 235 - 113
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

- Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
 - Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
 - Arkivit të Qeverisë